



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 02 .
Prishtinë, më 26.10.2017, në ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: kryetari i komisionit Igor Simić, Nënkryetari i parë-rë Xhelal Sveçla, Nënkryetari i dytë-të, Danush Ademi dhe anëtarët e komisionit: Kujtim Shala, Fadil Beka, Zoran Mojsilloviq, Jasmina Zhivkoviq, Sasha Millosavljević, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli, Mufera Srbica - Shinik dhe Duda Bale, anëtarë.

Nga pjesëmarrësit tjerë: Senad Karaahmetoviq, (OSBE), Zijush Ahmeti, këshilltar i Sekretariatit të KKK-së dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: koordinatorë – Natasha Prica-Tishma dhe zyrtarë e lartë ligjore - Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: kryetari i Komisionit, **Igor Simić**.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e Komisionit me datë: 9.10.2017;**
- 3. Shqyrtimi i projektplanit të punës së komisionit për vitin 2017;**
- 4. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Kryetari, konstatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri, pa ndryshime.

- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e Komisionit me datë: 9.10.2017.**

Kryetari, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtura më: 9.10.2017, pa vërejtje.

- 3. Shqyrtimi i projektplanit të punës së komisionit për vitin 2017;**

Kryetari, në kuadër të organizimit të brendshëm dhe procedurat e punës së komisionit për sesionin vjeshtor, kemi Planin e punës i cili është urdhërrëfyes i punës dhe aktiviteteve të komisionit i cili mundëson funksionimin e mbarvajtjes së punës, deri në fund të vitit.

Theskoj se në mbledhjen e fundit u diskutua lidhur me ditën e mbajtjes së mbledhjeve të komisionit. Mendon se është mirë të caktohet një ditë e përhershme për mbajtjen e takimeve të rregullta të komisionit, ndonëse është vështirë ti përmbahemi saktësisht, sepse takimet tona mvaren nga dinamika e punës së Kuvendit.

Pas një konsultimi të shkurtër rreth caktimit të ditës së javës për mbajtjen e mbledhjeve të komisionit, komisioni nxori këtë

Përfundim

Mbledhjet e rregullta të komisionit do të mbahen të hënave, në përputhje me planin e punës, duke filluar nga ora 13:00, porse duke iu përmbajtur njëherazi edhe dinamikave të punës së Kuvendit dhe trupave të tij të punës.

Ndërkaq kryesuesi i ftoi anëtarët e komisionit për diskutim rreth projektplanit të punës, të cilin Njësia mbështetëse e komisionit e ka ofruar dhe të propozojnë plotësimin e tij eventual.

Për plotësimin e tij dhanë propozime kryetari i komisionit Igor Simiq, Dude Bale, Sasha Millosavleviq dhe Albert Kinolli. Meqë nuk pati propozime tjera, komisioni nxori këtë

Përfundim

Plani i punës për vitin 2017, u miratua njëzëri, me plotësimet si vijon:

Të ftohen në raportim: Ministri i Punëve të Brendshme, Ministri i Financave dhe Komisionari për gjuhët.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

Përgaditur nga njësia mbështetëse e komisionit

Kryetar i Komisionit

Igor Simić
